



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



PROJEKT I USAID-it PËR INTEGRIMIN NDËRETNIK NË ARSIM (PINA)

ÇKA ARRITËM DERI TANI?

PINA është iniciativë katërvjeçare me buxhet prej 5.2 milionë dollarësh, në të cilin janë përfshirë të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Maqedoni. Qëllimi kryesor i PINA-s është që ta fuqizojë vetëdijen dhe të sigurojë trajnime të ndryshme, mbështetje teknike dhe nxitje të këshillave të shkollave, drejtorëve, arsimtarëve dhe të administratës për ta mbështetur integrimin ndëretnik në arsim.

Aktivitetet e realizuara në këtë projekt gjatë periudhës prill - dhjetor 2013 janë paraqitur për secilin prej katër komponentëve që janë të ndërlidhur dhe që plotësohen mes vete.

INFORMIMI I OPINIONIT DHE BASHKËSIVE

- Në periudhën prill-qershor 2013 janë realizuar **Punëtori kreative** në tetë shkolla të zgjedhura në komunat Kumanovë, Shtip, Kërçovë, Veles, Tetovë, Manastir, Karposh dhe Gazi Babë, që kishin për qëllim të zhvillohen aftësitë dhe njohuritë e nxënësve për kohezion ndëretnik përmes qasjeve dhe metodave kreative.
- **Shtatë ngjarjet promovuese** – shfaqja e shfaqjes teatrale, promovimi i një filmi të shkurtër dhe ekspozitë në Shtip, Veles, Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Kërçovë janë organizuar për të promovuar produktet e krijuara nga nxënësit e shkollave të mesme të cilët morën pjesë ne punëtoritë kreative.
- **Punëtori Forum teatër** – janë organizuar për nxënësit e shkollave të mesme nga Kumanova, Tetova, Kërçova, Manastiri, Velesi, Shkupi dhe Shtipi, të cilët kontribuojnë në zgjedhjen e çështjeve të caktuara të cilat e reflektojnë gjendjen aktuale të bashkësive shkollore dhe të sistemit arsimor.
- **Katër ngjarje promovuese** nga studimet në rast të zhvillimit të karrierës që tregojnë shembuj dhe praktika pozitive në kompani multi-kulturore janë organizuar në bashkëpunim me katër shkolla të mesme të komunës së Butelit, Tetovës, Manastirit dhe Strumicës.
- **Njëmbëdhjetë ngjarje solemne me prerjen e shiritit** u mbajtën në shkollat në komunat e Shkupit, Tetovës, Zherovinës, Zletovës, Dragomancës, Kumanovës, Strumicës, Banskos, Manastirit, Butelit dhe Qendrës, duke shënuar përfundimin e suksesshëm të procesit të rinovimit, si motivim për zbatimin e aktiviteteve të integritimit ndëretnik në shkolla.
- **Trajnim për trajnuesit për prodhimin e përmbajtjeve multimediale në internet në kontekst të integritimit ndëretnik në arsim** është organizuar për një grup prej dymbëdhjetë redaktorë dhe gazetarë për t'u përmirësuar aftësitë e tyre për bashkëpunim me mësuesit

dhe nxënësit për përdorimin e qasjes multimediale gjatë krijimit të përmbajtjeve të cilat e promovojnë integrimin ndëretnik.

- **Nëntë trajnime për prodhimin e përmbajtjeve multimediale në internet në kontekst të integritimit ndëretnik në arsim (Të rinjtë nëpërmjet mediave)**, nën drejtimin dhe mentorimin e redaktorëve dhe gazetarëve të përfshirë në PINA, u mbajtën për mësime ndëretnik dhe nxënësit e të gjitha shkollave të mesme nga rajonet e Shkupit, Shtipit, Manastirit, Strumicës, Velesit, Kumanovës, Strugës, Tetovës dhe Kërçovës. Qëllimi i aktiviteteve ka qenë për të ndihmuar mësuesit dhe nxënësit për të zhvilluar përgatitjet dhe aftësitë e tyre për përgatitjen e përmbajtjeve multimediale në internet.
- **Nëntë punëtori njëditore për anëtarët e ekipeve për integrim shkollor për prezantime publike efektive në kontekstin e integritimit ndëretnik në arsim** janë organizuar në të gjitha shkollat nga rajonet Shtip, Tetovë, Kumanovë, Veles, Kërçovë, Manastir, Strumicë, Strugë dhe Shkup. Trajnimi zhvillon aftësitë e pjesëmarrësve për prezantimin e aktiviteteve të ndryshme dhe

FOTOGRAFIA E MUAJIT



Aktivitete partnere midis dy/tre shkollave u mbajtën në mbarë vendin. Fëmijët e SHF "Kërste Misirkov" f. Bistricë, Manastir, SHF "Cirili dhe Metodi" nga Tetova dhe SHF "Aleksandar Turunxhiev" nga Kukureçani, Manastir, përmes argëtimit dhe lojërave mësuan për kulturën e tjetrit dhe krijuan miqësi të reja.



për informimin e bashkësive në nivel lokal për shembujt pozitiv të bashkëpunimit dhe integritit ndëretnik.

- **Debate publike** u mbajtën në kuadër të klubeve debatuuese në katër shkolla në pilot komunitet me qëllim që të vazhdojë zhvillimi i aftësisë dhe kapaciteti i nxënësve - debatues përmes temave dhe subjekteve të ndryshme.
- **Filluan aktivitete në tetë klube të reja debatuuese**, ku nxënësit e përzier, në kuadër të klubeve debatuuese filluan ligjëratat javore dhe punëtori për të zhvilluar aftësitë e të rinjve për debat.
- U organizua **intervistë** me aktoren e njohur të Teatrit shqiptar, Amernis Nokshiqi – Jovanovska dhe gazetarin Borjan Jovanovski, me qëllim që t'i ndajnë përvojat e tyre dhe shembujt të cilat promovojnë diversitetin dhe kohezionin ndëretnik. Intervista është publikuar në disa media dhe disa rrjete sociale: <http://www.youtube.com/watch?v=dQkrEbOypMI&feature=youtu.be>
- **Gjashtë takime joformale me redaktorë dhe gazetarë të Media Outlets** janë organizuar me qëllim të informimit për ngjarjet vijuese dhe aktivitetet të cilat zbatohen në kuadër të PINA. Janë diskutuar dhe dakorduar mundësitë për prezencën e përfaqësuesve në projekt në programet e mëngjesit dhe programet e tjera, si dhe për azhurnimin e rregullt të opinionit nga ana e mediave.



Punëtori forumi teatral e mbajtur me nxënësit përfaqësues të shkollave të mesme në Tetovë. Në këto punëtori, nxënësit zgjidhin një situatë të caktuar përmes aktrimit. Kjo është një nga tetë punëtoritë të mbajtura në Maqedoni.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË DREJTORIVE TË SHKOLLAVE DHE MËSIMDHËNËSVE

- **Trajnim fillestar për grupin e ri të trajnuesve master** u caktua për 14-të kandidatët e rinj për trajnues master me qëllim që pjesëmarrësit të njohohen me konceptin për integrimin ndëretnik në arsim dhe ta theksojnë rolin e shkollës në kundërshtimin e stereotipave dhe paragjytimeve si dhe sfidave të tjera.
- **Trajnim për trajnuesit për rolin e këshillave shkollorë për ndryshimet e integritit ndëretnik në arsim** u organizua me qëllim që pjesëmarrësit të njohohen me rolin e këshillave shkollorë dhe në bashkësi.
- **Përgatitja, zbatimi dhe mbështetja për ciklin e dytë të trajnimeve për përfaqësuesit e këshillave shkollorë** në fazën 2 të PINA u zbatua, në të cilën morën pjesë shtatë grupe përfaqësuesish të shkollave fillore dhe të mesme.
- **Punëtori për mësimdhënës/trajnues për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta sportive dhe argëtuese me nxënësit** u zbatua për 40 mësimdhënës të 8 shkollave fillore nga komunitetet Çair, Tetovë, Kumanovë, Resnjë dhe Manastir. Qëllimi ishte që të zhvillohen aftësitë e mësimdhënësve për shfrytëzimin e ushtrimeve qëllimi i së cilave është zbatimi i lojërave të përbashkëta rekreative dhe sportive me nxënësit për përmirësimin e integritit ndëretnik në arsim.
- **Aktivitete sportive dhe argëtuese** janë organizuar për nxënësit dhe mësimdhënësit në Manastir dhe Tetovë ndërsa ngjarja përfundimtare u organizua në stadiumin në Çair në Shkup, me pjesëmarrje të tetë shkollave fillore nga Tetova, f. Romanovc, f. Tabanoc, Çairi, Resnja dhe Manastiri. Në ngjarje morën pjesë mbi 360 nxënës nga shkollat e përfshira.
- **Punëtori me trajnuesit master për përgatitjen e trajnimeve me ekipet për integrim shkollor të Fazës 2** u mbajt në qershor të vitit 2013. Sesionet për aktivitete të përbashkët janë zbatuar më detajisht, që mundëson interaksionin e nxënësve të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore (ekskursionet, seksione shkollorë, aktivitete sportive, punëtori multikulturor).
- **Trajnime të Ekipeve për integrim shkollor të Fazës 2** janë organizuar dhe zbatuar nga ana e trajnuesve master për SIT nga 19 shkolla. Qëllimi kryesor i trajnimeve ishte pjesëmarrësit ta kuptojnë konceptin e integritit ndëretnik në arsim si model i cili nxënësve u mundëson aktivitete të përbashkëta dhe interaksion me grupet e përziera etnike/gjuhësore të nxënësve.
- **Disemimi i trajnimeve për integrimin ndëretnik në shkollat e fazës së dytë.** Gjatë këtij muaji, janë mbajtur trajnime për disemimin e nivelit shkollor nga ana e SIT në 160 shkolla. Qëllimi i trajnimeve ishte shkolla të njohohet me konceptin e integritit ndëretnik i cili promovon model të arsimit në të cilin nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike u mundësohet të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta.
- **Trajnim për trajnuesit për shërbimet profesionale të shkollave** për involvimin e prindërve në promovimin e integritit ndëretnik në arsim u organizua për trajnuesit master – me qëllim që ata të përgatiten për zbatimin e trajnimeve me shërbimet profesionale në shkollat e 58 pilot shkollave për involvimin dhe bashkëpunimin me prindërit.
- **Trajnime për involvimin e prindërve** për zhvillimin e integritit ndëretnik në arsim për tërë shërbimin profesional të shkollave





janë zbatuar në 58 pilot shkolla. Me këtë u rrit niveli i mirëkuptimit dhe nevojës së involvimit të prindërve në zbatimin e aktiviteteve. Gjithashtu, janë organizuar trajnime për shtatë grupe të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të fazës 2.

- **Në dy punëtori me kuadrin arsimor të fakulteteve për arsimtarë** janë tubuar pjesëmarrës me qëllim që të iniciohet procesi i integritimit ndëretnik në arsimin e lartë, me ç'rast do të sigurohet qëndrueshmëri në sistemin arsimor. Pjesëmarrësit i shqyrtuan mundësitë për integrimin e moduleve për integrimin ndëretnik në arsim në lëndët të cilat mësohen në fakultetet pedagogjike.
- **Procesi i inkorporimit të integritimit ndëretnik në arsim në Indikatorët për cilësi në punën e shkollave (ICPSH)** u kompletua në bashkëpunim me inspektorët e Inspektoratit shtetëror të arsimit.
- **Doracaku „Cilësia në procesin arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë 2012/13“** u përgatit dhe do të promovohet nga ana e MASH dhe Inspektorati shtetëror i arsimit.
- **Takime të mentorëve me Ekipet për integrim shkollor** i përgatitën trajnuesit master për zbatimin e takimeve të përbashkëta të mentorëve me 194 shkolla të fazës së dytë. Takimet e mentorëve siguruan mbështetje për ekipet për përgatitjen e disemimit të trajnimeve në nivel shkollor. Takimi i dytë i mentorëve u mbajt me SIT prej 190 shkollave fillore dhe të mesme në nivelin rajonal.
- **U dërgua pyetësor në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në pilot fazë dhe fazën 2** në lidhje me gatishmërinë e prindërve për t'u involvuar dhe për të dhënë kontributin e tyre për aktivitetet e PINA.



“Të gjithë jemi të barabartë, rritemi së bashku” – mesazh nga një pjesëmarrës në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve midis shkollave partnere SHF “Besa” nga f. Veshalla, Tetovë, dhe SHF “Nikolla Vapcarov” nga Strumica. Gjatë vitit 2013 janë formuar 52 partneritete midis 128 shkollave të cilat bashkërisht i realizojnë aktivitetet e tyre.

SHKOLLAT MODELE

- Janë mbajtur **trajnime të mësimdhënësve nga shkollat modele për njohjen dhe kundërshtimin e stereotipave dhe paragjykimeve etnike** (me dy grupe të mësimdhënësve) në çdo shkollë model.
- **Në trajnimin për prindërit për rritjen e vetëdijes së tyre për PINA dhe involvimin e tyre në aktivitetet shkollore** morën pjesë përfaqësues të Këshillit të prindërve nga të gjitha shkollat modele dhe dy përfaqësues të ekipeve për integrim shkollor (SIT) nga çdo shkollë modele.
- **Klubi për dramë** e shkollës modele nga Gostivari e realizoi shfaqjen “Nisma” në Qendrën kulturore-informative në Shkup. Në shfaqje ishin të pranishëm edhe nxënësit e shkollave të mesme “Zdravko Cvetkovski” dhe “Zef Lush Marku” nga Shkupi.
- **U mbajt trajnim për Ekipet për integrim shkollor (SIT) nga modelet e reja njëgjuhëshe për vetëvlerësimin, koordinimin dhe ndjekjen e aktiviteteve shkollore**, për përfaqësuesit e SIT nga shkollat fillore modele “Vëllezërit Milladinov” dhe “Bajram Shabani” nga Kumanova. Qëllimi i trajnimit ishte që të sigurohet përshkrim i detajuar i aktiviteteve dhe përgjegjëse për zbatimin e tyre në shkolla.
- U përgatit **Doracak për aktivitete të përbashkëta shkollore** qëllimi i së cilave është dizajnimi i punëtorive – grupeve të aktiviteteve të cilat do të vendosin dhe do të krijojnë grup i cili do të ishte pjesë përbërëse e doracaktit për aktivitete të përbashkëta shkollore.
- Në çdo shkollë modele/shkollë modele në partneritet janë mbajtur **trajnime të mësimdhënësve të shkollave modele për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve**, në të cilat u prezantua metodologjia për punën me grupe të përziera etnike/gjuhësore të nxënësve.
- U organizua **Trajnim për shërbimin profesional dhe për drejtorinë shkollore të shkollave modele në partneritet për zgjedhje demokratike të trupave të nxënësve (përfaqësuesve klasor dhe shkollor)** me qëllim që shkollave t’u sigurohen procedura për zgjedhjen demokratike të trupave shkollore.
- Janë zbatuar **dy trajnime për mësimdhënës të shkollave modele për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve përmes mësimi të rregullt** – një me shkollën modele partnere dhe një me shkollat modele fillore tregjuhëshe me mësimdhënësit e klasave të katërta. Bashkë me anëtarët e SIT dhe këshilltarët e BZHA, është përpiluar plani veprues për realizimin e ekskursioneve me nxënësit e gjuhëve të ndryshme mësimore.





- Janë realizuar **tre trajnime për mësimdhënës për bashkëpunim përmes aktiveve profesionale** me mësimdhënësit të cilët ligjërojnë gjuhë të huaja dhe gjuhën amtare në shkollat e mesme modele, me mësimdhënësit e shkollave fillore modele tregjuhëshe dhe me mësimdhënësit e shkollave modele partnere. Trajnimet rezultuan me strategji për përforcimin e bashkëpunimit midis mësimdhënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore.
- Është organizuar **takim pune me këshilltarët e BZha** të cilët janë përzgjedhur për t'i ndjekur dhe mbështesin aktivitetet në shkollat modele. Këshilltarët janë informuar në detaje për aktivitetet projektuese, rolin e tyre dhe detyrat në kuadër të projektit.
- Në trajnimin për mësimdhënësit të cilët ligjërojnë letërsi për këmbimin e materialeve mësimore janë involvuar dy grupe mësimdhënësh të cilët ligjërojnë letërsi dhe gjuhë amtare nga të gjitha shkollat modele qëllimi i së cilave ishte shqyrtimi i materialeve mësimore dhe mundësia për shfrytëzimin e tyre gjatë prezentimit të realitetit multikulturor në vend.
- Janë mbajtur **pesë trajnime për kryesitë e bashkësive shkollore për ndërmarrjen e nismave të nxënësve**, nga një në çdo shkollë partnere modele. Qëllimi ishte nxënësit t'i aprovojnë konceptet bazë për veprim përmes bashkësisë shkollore dhe zhvillimin e planeve vepruese për ndërmarrjen e nismave të nxënësve për grumbullimin e mjeteve të cilat janë investuar me qëllim që të bëhen ndryshime të caktuara në shkollë.
- Manifestime dhe ekskursionet janë organizuar** në Kumanovë dhe Kërçovë. Një shkollë modele nga Kumanova organizoi manifestim me rastin e ditës ndërkombëtare të mësuesit, në të cilin morën pjesë mysafirë të shkollës modele "Bajram Shabani", të cilët zbatuan një aktivitet të veçantë dhe të përbashkët. Në Kërçovë, me rastin e javës së fëmijëve, është organizuar manifestim i integruar shkollor me nxënës të të gjitha gjuhëve mësimore. Gjithashtu, është organizuar edhe

punëtori për ëmbëlsira tradicionale për Kurban Bajram.

- Është organizuar **trajnim për punëtori multikulturore** për zbatues të rinj të punëtorive multikulturore me mësues të të gjitha shkollave modele. Qëllimi i trajnimit ishte që të demonstron modelin dhe karakteristikat e zbatimit të punëtorive dygjuhëshe, me ç'rast në trajnimet e radhës mësuesit do t'i simulojnë punëtoritë të cilat i kishin si detyra për qëllimet e ushtrimeve.
- Trajnim për transformimin e kulturës shkollore në multikulturaizëm** është organizuar me përfaqësuesit e drejtorive të shkollave në shkollat modele. Trajnimi shërben për njoftimin e pjesëmarrësve me të gjitha aspektet të cilat duhet të bëjnë ndikim në mënyrën e funksionimit të shkollës kështu që kjo gjë do ta reflektojë karakterin multikulturor të komunës. Ikonografia dhe organizimi i orëve (turneve dhe hapësirës) ishin temat kryesore.
- Në shkollat modele janë zbatuar **nismat e nxënësve** në kuadër të së cilave nxënësit kanë organizuar turneun sportiv në futboll me ekipet e nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore, kanë organizuar Festë të Vitit të Ri, kanë bërë kartolina për krishtlindjet të cilat janë shitur për grumbullimin e mjeteve që të investohen në shkollë dhe kanë mbledhur letra dhe plastikë për riciklim, të cilat gjithashtu janë shitur.
- Prindërit janë involvuar** në aktivitete të cilat janë zbatuar në shkollat modele. Në shkollën e mesme Zdravko Cvetkovski, prindërit dhe nxënësit morën pjesë në zbulimin e vendit ku nxënësit e kanë organizuar Festën e tyre të Vitit të Ri. Përveç kësaj, prindërit e Sande Shterjoski morën pjesë në punëtorinë për përgatitjen e zbulimeve shkollore.
- Memorandum për bashkëpunim.** Është nënshkruar Memorandum për mirëkuptim me pesë shkolla modele dhe me komuna përkatëse. Memorandumi për bashkëpunim me shkollën modele nga Ohri pritet të nënshkruhet në vitin 2014.



Trajnim për ndërtimin e punës ekipore dhe koordinimin e aktiviteteve për anëtarët e SIT në shkollat fillore modele, i mbajtur në Shkup.



Manifestim i integruar shkollor në SHF shumëgjuhëshe modele "Bratstvo Edinstvo" nga Ohri. Nxënës të gjuhëve të ndryshme mësimore punojnë bashkë në përpunimin e produkteve kreative.

NXITJA E SHKOLLAVE

- U mbajt pjesa e parë e trajnimeve për mirëmbajtjen e shkollave për përfaqësuesit e ekipeve për rinovimin e shkollave nga të gjitha shkollat e përzgjedhura për rinovim gjatë vitit 2013. Fokusi i trajnimeve ishte identifikimi i nevojave për rinovimin, definimin e prioriteteve dhe përgatitjen e aplikacioneve për rinovim.
- Janë furnizuar dhe dorëzuar komplete me vegla për rinovimin e shkollave deri te shkollat e zgjedhura për rinovim në vitin 2013. Këto komplete me vegla dedikohen për mirëmbajtjen e shkollave të rinovuara.
- Janë ndërtuar edhe vend qasje në katër pilot shkolla për persona me pengesa fizike në 4 shkolla të cilat janë rinovuar në pilot fazë.
- U mbajt pjesa e dytë e trajnimeve për mirëmbajtjen e shkollave për shkollat e zgjedhura për rinovim gjatë vitit 2013. Fokusi i trajnimeve ishte përgatitja e planeve vjetore dhe buxheteve për mirëmbajtjen e ndërtesave. Këto trajnime i kanë vizituar 77 persona, përfaqësues të ekipeve për rinovimin e ndërtesave shkollore.
- Shpallja e tenderëve publik për përzgjedhjen e kompanive të ndërtimit përbëhet nga përgatitja e dokumentave për tender, kurse shpalljet për rinovim janë publikuar në dy gazetatat ditore Dnevnik dhe Koha (maqedonisht dhe shqip) dhe në ueb faqen të Projektit për shkollat e zgjedhura për rinovim në vitin 2013.
- Vlerësimi i kompanive për zbatimin e rinovimeve përbëhet nga intervistat me tre kompanitë e para të renditura për zbatimin e projekteve në shkollat e zgjedhura.
- Përzgjedhja e kompanive të licencuara për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve është kryer me qëllim të procesit të rinovimit të shkollave të përzgjedhura.

- Janë nënshkruar Memorandume për bashkëpunim me të gjitha shkollat dhe komunat.
- U bë vlerësimi dhe përzgjedhja e kompanive për zbatimin e rinovimeve të tre kompanive më të vlerësuara. Janë përzgjedhur ofertuesit më të volitshëm, dhe rezultatet e procedurave të tenderit janë shpallur në <http://pmio.mk/category/tender-results/>.
- Përzgjedhja e kompanive të licencuara për kryerjen e mbikëqyrjes së zbatimit të punimeve. Janë dërguar kërkesat për ofertat për mbikëqyrjen e zbatimit të katër projekteve. Janë pranuar oferta dhe janë përzgjedhur kompanitë për monitorimin e zbatimit të projekteve në Vinicë, Veles, Nagoriçan të Vjetër dhe Kumanovë.
- Janë nënshkruar marrëveshjet me kompanitë për zbatimin e punimeve dhe kompanitë për mbikëqyrjen e zbatimit për projektet për rinovimin në dhjetë shkolla.
- Janë organizuar prezantime në punë në dhjetë shkolla me të cilat është shënuar fillimi i aktiviteteve për rinovim në terren.
- Është bërë pranimi teknik në të gjitha objektet dhe janë organizuar takime me zbatuesit, me mbikëqyrësit, me përfaqësuesit e shkollave dhe komunave.
- Pajisja për mirëmbajtjen e shkollave dhe doracakut për përdorimin e saj janë dorëzuar të të gjitha shkollat e rinovuara.
- Janë organizuar takime mujore për vëzhgimin e punës për ndjekjen e punimeve për mirëmbajtjen e shkollave me sekretarët e shkollave dhe me stafin teknik për ndjekjen e punimeve për mirëmbajtje në shkolla modele.
- U organizuan takime të mentorëve në gjashtë shkolla në mënyrë që të ndiqet puna e shkollave në lidhje me përgatitjen e planeve vjetore dhe buxhetet për mirëmbajtje.



Rinovimi i SHF "Nikolla Karev" nga Koçani është një nga njëmbëdhjetë shkollat e rinovuara në vitin 2013. Shkolla "Nikolla Karev" i është nënshtruar një rinovimi komplet në lidhje me gjendjen fillestare duke iu falënderuar partneritetit midis PINA-s, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Komunës së Koçanit dhe shkollës.

I presim rrëfimet, ngjarjet dhe risitë tuaja...

Na kontaktoni dhe këmbeni me ne në adresën: rr. Kozle 1-b, 1000 Shkup, info@mcgo.org.mk

BULETIN

Dhjetor 2013

DREJTPËRDREJT NGA PINA

6



Aktivitetet e përbashkëta sportive dhe argëtuese në SHF "Adem Jashari", komuna Çair.




Pjesëmarrës kreativ në trajnimin për shkolla modele cila u mbajt në Shkup

A E DINI SE?

Rastësi interesante. Më 13 nëntor të vitit 2013, Facebook faqja e USAID Maqedoni ka fituar admiruesin e 13,000 në ora 13:00.



Total Page Likes as of Today: 13,000 11/13/2013



Projekti i USAID-it për integrimin ndëretnik ne arsim implementohet në partneritet me shtatë organizata lokale: Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhje të Konfliktëve, Loja, Sumnal, Multimedia, Moja kariera, Instituti Maqedonas i Mediave dhe Forumi Arsimor i të Rinjve.

INFORMACIONE DHE KËSHILLA TË DOBISHME

Ueb faqja jonë
www.pmio.mk

ofron informacione lidhur me Projektin e USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim - ngjarje, rrëfime dhe mundësi të ndryshme, të përgatitura dhe të mundësuar nga ekipi i projektit dhe bashkëpunëtorët tanë.

Ju ftojmë ta vizitoni!

Ne jemi edhe aty të pranishëm me rrëfimet tona të suksesshme!

DIÇKA E PADETYRUESHME NGA PINA



Nxënësit e SHF "Stiv Naumov" nga Manastiri në ngjarjen solemne të prerjes së shiritit me të cilin u shënua fundi i procesit të rinovimit të kësaj shkolle. Kjo është një prej ngjarjeve solemne të njëmbëdhjeta të mbajtura në vitin 2013.

Informacionet e dhëna në këtë buletin nuk janë informacione zyrtare të Qeverisë së SHBA-ve dhe nuk i paraqesin pikëpamjet ose qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së SHBA-ve.